

## Deklarata e Fiugjit (Fiuggi): Gratë në Muzikë

- Çdo vend është i ftuar të inkurajojë krijimin e organizmave përgjegjës për dokumentacionin dhe informacionin që kanë të bëjnë me kompozitorët e lindura brenda *kufijve kombëtarë*. Këto organizata duhet të jenë në gjendje të dërgojnë dhe të marrin informacione në lidhje me ‘gratë në muzikë’ dhe organizatat e tjera, duhet të mbledhin informacion për strukturat institucionale dhe muzikore në vendin e vet, përgjegjës për *krijimin, nxitjen dhe programimin* e muzikës: Festivale të muzikës bashkëkohore dhe antike, festivale të qendëruar mbi muzikën e kompozitoreve dhe të interpretueseve, mundësinë për financime dhe bursa studimi. Muzikantët duhet të përpiqen të marrin pjesë më tepër në programimin, nxitjen dhe krijimin e veprave të reja, për të pasur një rritje të përqindjes së veprave të realizuara nga gratë në repertorin e tanishëm (muzikë simfonike, muzikë dhome dhe tradicionale) dhe për të inkurajuar shkëmbimin ndërmjet kompozitoreve dhe interpretueseve. Organizatat për ‘gratë në muzikë’ do të komunikojnë nëpërmjet internetit.
- Legjislacioni, në pjesën më të madhe të vendeve, parashikon kushte dhe të drejta të barabarta për gratë dhe teorikisht kjo gjë do të duhej të lejonte pjesëmarrjen në çdo fushë që ka interes për gratë. Por, *praktikisht*, shpesh gjërat nuk janë kështu. Organizatat për ‘Gratë në Muzikë’ duhet të kontrollojnë nëse realiteti social i vendeve të tyre është i orientuar sipas legjislacionit në fuqi. Në shumë vende gratë nuk janë të përfaqësuara ashtu siç duhet sipas niveleve institucionale. Duhet të nxisim praninë e grave në *komisione*, komitete, dhe në çdo vend ku talentet dhe përgatitja e tyre mund të jenë të nevojshme. Gratë në politikë duhet të informohen nga ndryshimi ndërmjet legjislacionit dhe praktikës dhe duhet të bëhen avokate për muzikantët, kryesisht përsa i përket mundësive për financime.
- Informacionet që kanë të bëjnë me gratë në muzikë duhet të jenë të disponueshme për mësuesit e muzikës, gra dhe burra. Kontributi i muzikanteve, në çdo kulturë, duhet të bëhet pjesë e *kurrikulave* muzikorë në fushën shkollore, universitare dhe në akademitë. Prindërit duhet të inkurajohen që të ushqejnë talentet muzikore të bijave dhe bijve të tyre, duke respektuar traditat dhe vlerat kulturore të femrave dhe meshkujve.
- Muzikantët duhet të lexojnë, të kuptojnë dhe të përdorin dokumentat e UNESCO-s të njohur si “E drejta e Artistit” dhe dokumentin Përfundimtar të Konferencës Botërore Ndërqeveritare në lidhje me “Politikat Kulturore për Zhvillimin”, të mbajtur në Sokholm në 1998-ën.
- Duhet të njihet kontributi i grave, për kulturën dhe zhvillimin, për të siguruar pjesëmarrjen e tyre në formulimin dhe aktivizimin e politikave kulturore në çdo nivel, për të siguruar hyrjen në vendet me pushtet në botën e kulturës dhe spektaklit. Është e rëndësishme që të punohet për të ruajtur, nxitur, mbajtur dhe për të mbrojtur të drejtat artistike të muzikanteve dhe të krijimtarisë së çdo komuniteti. Vetëm në këtë mënyrë mund të kapërcejmë dhe të ndryshojmë botëkuptimin e vjetër monokulturor mashkullor të kulturës dhe të trashëgimisë artistike.
- Roli ynë i rëndësishëm si gra, në transmetimin e trashëgimisë së veçantë kulturore, konkrete dhe abstrakte, nuk duhet të injorohet, sepse i përket jo vetëm një gjinie, populli apo kulture por krejt njerëzimit.

1

---

<sup>1</sup> Në 1996-ën, në fund të Simpoziumit të Parë Ndërkombëtar “Gratë në Muzikë: Takimet në Borgo” muzikante nga njëzetegjashtë vende (kompozitore, interpretuese, drejtuese, muzikologe, organizatore, operatore kulturore) kanë nënshkruar një dokument i njohur si “The Declaration of Fiuggi, 1996” (Deklarata e Fiugjit, 1996).

Ky dokument, që i është shpërndarë në të gjithë botën muzikantëve, organizatave dhe enteve muzikore, dhe në botën akademike, përcakton ato objektiva, të njohur si objektiva kryesorë për muzikantët. Në 1999-ën Deklarata është rishikuar dhe në Shtatorin e 2000-shit është përdorur botimi aktual.